**LIGJ**
**Nr.8283, datë 3.2.1998**

**PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 1998**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
BUXHETI I PËRGJITHSHËM

Neni 1

Buxheti i Shtetit i vitit 1998 është:
- të ardhurat .....86 090 milionë lekë
- shpenzimet .....148 919 milionë lekë

Neni 2

Buxheti i sigurimeve shoqërore i vitit 1998 është:
a. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror
- të ardhurat gjithsej .....23 018 milionë lekë
* nga kontributet .....13 285 milionë lekë
* të tjera nga financimi me destinacion
të vitit 1997.....200 milionë lekë
* transferime nga buxheti i shtetit .....9 533 milionë lekë
- shpenzimet .....23 018 milionë lekë
Paga minimale për efekt të pagimit të kontributit
të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është .....6 040 lekë në muaj
b. Skema e sigurimit suplementar
- të ardhurat gjithsej.....68 milionë lekë
* nga kontributet ....18 milionë lekë
* transferime nga Buxheti i Shtetit..50 milionë lekë
- shpenzimet.....68 milionë lekë

Neni 3

Buxheti i sigurimit shëndetësor i vitit 1998 është:
- të ardhurat .....2 233 milionë lekë
* nga kontributet .....1 148 milionë lekë
* transferime nga Buxheti i Shtetit.....1 085 milionë lekë
- shpenzimet .....2 233 milionë lekë

KREU II
BURIMET PËR MBËSHTETJEN E SHPENZIMEVE BUXHETORE

Neni 4

Të ardhurat e Buxhetit të Shtetit sipas grupeve kryesore janë:

të ardhura nga fondi kundërparti .....300 milionë lekë
të ardhura tatimore.....64 800 milionë lekë
nga këto:
të ardhura nga taksat lokale .....600 milionë lekë
të ardhura nga tatimi mbi pasurinë..550 milionë lekë
- të ardhura jotatimore.....19 990 milionë lekë
- ndihma të huaja për projekte .....1 000 milionë lekë

Neni 5

Kufiri maksimal i financimit të deficitit të buxhetit të përgjithshëm nga burimet e brendshme është 30 406 milionë lekë, nga i cili 1 500 milionë lekë financohet nga të ardhurat e privatizimit. Kufiri i financimit nga burime të huaja është 32 423 milionë lekë nga i cili 7063 milionë lekë mbështetje direkte për deficitin.

Neni 6

Disbalancimi i mundshëm gjatë vitit i buxhetit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore financohet nga fondi i garantimit të pensioneve.

KREU III
SHPENZIMET E BUXHETIT TË SHTETIT

Neni 7

Shpenzimet sipas drejtimeve kryesore janë:
- shpenzime korente .....105 313 milionë lekë
- shpenzime kapitale.....37 971 milionë lekë
- kosto e ristrukturimit të bankave .....500 milionë lekë
- rezervë e Këshillit të Ministrave .....2 635 milionë lekë
- kontigjence.....2 500 milionë lekë

Kufiri i shpenzimeve për çdo Ministri dhe Institucion Qendror, i ndarë në fonde të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara, është sipas pasqyrës nr.1 bashkëngjitur.

Neni 8

Në zërin fonde të kushtëzuara përfshihen shpenzimet nga financimet e huaja për projekte dhe nga të ardhurat që me ligj ose me akte nënligjore i takojnë institucioneve buxhetore. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrisë së Financave, përcakton llojin e të ardhurave që me akte nënligjore do t'ju lihen në përdorim institucioneve buxhetore, si dhe kriteret e përdorimit të tyre në përputhje me kufijtë e vendosur në këtë ligj. Fondet e kushtëzuara, me përjashtim të financimeve të huaja dhe të ardhurave të pushtetit lokal, krijohen dhe përdoren brenda vitit buxhetor.

Për çdo tejkalim të të ardhurave tatimore të pushtetit lokal nga taksat lokale dhe tatimi mbi pasurinë të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji, Ministria e Financave autorizon në të njëjtën masë rritjen e kufirit të shpenzimeve të kushtëzuara për pushtetin lokal të paraqitur në këtë ligj.

Neni 9

Fondi i kontigjencës prej 2500 milionë lekë përdoret për ruajtjen e deficitit në masën 1 500 milionë lekë dhe 1 000 milionë lekë për investime. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për përdorimin e fondit prej 1 000 milionë lekë për shpenzime për investime vetëm në 6 mujorin e dytë të vitit 1998, në përputhje me ecurinë e treguesve të të ardhurave në fund të 6 mujorit të parë të vitit 1998. Përdorimi i kontigjencës së caktuar për ruajtjen e defiçitit buxhetor bëhet vetëm me miratim të Kuvendit Popullor.

Neni 10

Shpenzimet kapitale nga burime të brendshme janë 11 137 milionë lekë dhe nga burime të huaja 26 834 milionë lekë. Lista e përmbledhur e objekteve është sipas pasqyrës nr.2 bashkëngjitur.

Neni 11

Shpenzimet korente dhe shpenzimet për investime për pushtetin gjyqësor janë sipas pasqyrës nr.3 bashkëngjitur.

Neni 12

Kufiri i shpenzimeve sipas pasqyrave nr.1, 2 dhe 3 mund të rishpërndahet gjatë vitit midis institucioneve dhe objekteve nga Këshilli i Ministrave deri në masën 10 për qind të totalit të fondeve të parashikuara për çdo institucion dhe objekt. Për objektet e investimeve ky kufizim është i vlefshëm vetëm për ato që financohen me burime të brendshme.

## KREU III
## DISPOZITA TË TJERA

Neni 13

Kriteret e ndarjes dhe përdorimit të të ardhurave nga tatimi mbi pasurinë janë të njëjta me ato të përcaktuara në nenin 11 të ligjit nr.8054, datë 30.12.1995 "Për buxhetin e shtetit të vitit 1996", ndryshuar me ligjin nr.8172, datë 21.12.1996 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8054, datë 30.12.1995".

Neni 14

Në rast të mosrealizimit të planit të të ardhurave në masën e parashikuar në Buxhetin e Shtetit të vitit 1998, shpenzimet do të ulen në të njëjtën masë nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrisë së Financave.

Neni 15

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

## KREU IV
## BUXHETI FAKTIK 1996

Neni 16

Miratohet buxheti faktik për vitin 1996 dhe burimet e tij të financimit si më poshtë:
1. Të ardhurat gjithsej.....52 907 milionë lekë
2. Shpenzimet gjithsej.....87 596 milionë lekë
Nga këto:
Buxheti i Sigurimeve Shoqërore
- Të ardhurat .....11 645 milionë lekë
- Shpenzimet .....17 871 milionë lekë
Buxheti i Sigurimeve Shëndetësore
- Të ardhurat .....1 020 milionë lekë
- Shpenzimet .....1 255 milionë lekë
3. Deficiti Buxhetor.....- 34 689 milionë lekë
4. Financimi i Deficitit .....34 689 milionë lekë
- I brendshëm.....27 680 milionë lekë
Kredi nga BSH.....5 100 milionë lekë

Bono Thesari .....23 678 milionë lekë
Ndryshim gjendje arke.....- 1 587 milionë lekë
Detyrime të përkohshme .....489 milionë lekë
- Financim i huaj neto (Kredi).....7 009 milionë lekë

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17

Çdo akt ligjor e nënligjor që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohet.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.1.1998.

**Shpallur me dekretin nr.1997, datë 11.2.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**